



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike



**Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za
Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety**

RAPORT I AKTIVITETEVE DHE VEPRIMEVE TË NDËRMARRA TË AKSP-së GJATË PERIUDHËS SË PANDEMIS (COVID 19)



Vushtrri, 12 Mars - 01 Qershor 2020

Republika e Kosovës sikurse edhe shumë shtete tjera të botës është përballur me sfidën globale të quajtur Corona Virusit (Covid 19). Me qëllim të menaxhimit dhe përballjes sa më efikase ndaj kësaj pandemie Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 11.03.2020 ka nxjerr Vendimin nr.01/07 me anë të cilit ka reduktuar dhe pezulluar shumë aktivitete të Institucioneve të saj.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, konformë zbatimit të Vendimit të lartcekur të qeverisë së Republikës së Kosovës, më datë 12.03.2020 ka ndërprerë procesin edukativo-arsimor të kadetëve të Policisë së Kosovës dhe ligjëratat e studentëve të Fakultetit të Sigurisë Publike si dhe janë pezulluar të gjitha aktivitetet nga fushë veprimtaria e Akademisë.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është e përkushtuar për mbrojtjen dhe parandalimin e infektimit të stafit dhe vijuesve të saj

Sfidat përballuese me pandeminë Covid 19 kërkojnë që të gjitha institucionet të jenë fleksibile dhe në hap me rekomandimet dhe masat e Ministrisë Shëndetësisë (MSH) dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP).

Bazuar në vlerësimet e rrjedhave të gjendjes epidemiologjike, MSH dhe IKSHPK vazhdimisht ka rekomanduar masa shtesë dhe në bazë të këtyre rekomandimeve janë marrë vendime dhe aktivitete në favor të mbrojtjes së zyrtarëve të AKSP-së dhe qytetarëve në përgjithësi

Ky raport prezanton të gjitha aktivitete reale të ndërmarra nga ana e AKSP-së që nga shpallja e pandemisë apo pezullimi i aktiviteteve me 12.03.2020 e deri tek rikthimi gradual i nëpunësve me 01.06.2020

✓ Reduktimi i stafit dhe caktimi i listës së stafit esencial

AKSP-ja me qëllim të zbatimit të masave të parapara konformë rekomandimeve të Institucioneve relevante, ka organizuar takim me të gjithë personelin udhëheqësit ku është diskutuar dhe kërkuar të bëhet seleksionimi i stafit për organizimin e punëve sipas prioriteteve dhe lirimit e disave nga puna për shkak të përkujdeset ndaj fëmijëve, sëmundjeve kronike, kryerja e punëve nga shtëpia etj.

Pra është hartuar dhe planifikuar stafi sipas të gjitha kërkesave të nevojshme.

Nga data 15.04.2020 në përputhje me pikën 9 të masave të përcaktuara me vendim të Qeverisë, AKSP-ja me vendimin e Ministrit të MPB të datës 15/04/2020 ka funksionuar vetëm me staf esencial (AKSP-ja ka dërguar listën e stafit esencial në MPBAP për aprovim në përbërje nga 45 për lejimin e qarkullimit dhe kryerjen e disa funksioneve të veta)

Po ashtu konformë kërkesës së MPBAP për caktimin e zyrtarëve kujdestar për operim në Qendrën Operative të MPBAP-së, AKSP-ja ka caktuar 3 zyrtarët përgjegjës në këtë qendër me qëllim të koordinimit të punëve.

✓ Krijimi i rrjeteve të komunikimit mes zyrtarëve të AKSP-së

Pas situatës së krijuar dhe reduktimit të stafit të AKSP-së me qëllim të mbajtjes së kontakteve dhe kryerjen e punëve esenciale, konformë mundësive teknologjike si lehtësim i komunikimit në distancë përmes platformës skype, AKSP-ja ka filluar krijimin e grupeve të ndryshme si:

- Grupi mes menaxhmentit të AKSP-së
- Grupin e stafit akademik të FSP-së dhe
- Grupet mes njësive organizative



Përmes takimeve të shumta që janë realizuar janë shkëmbyer edhe dokumente , ide dhe janë realizuar aktivitete nga shtëpia.

✓ Vazhdimi i mësimit –ligjëratave online për studentët e FSP-së

Nga data 28 prill 2020 – Fakulteti i Sigurisë Publike në koordinim me të gjithë mësime të mësimdhënësit dhe me përkrahjen e Divizionit të TI, ka unifikuar platformën elektronike Google Meet dhe Google Classroom për ndjekjen e mësimit online.

Po ashtu janë zhvilluar edhe modulet e punës praktike (internshipit) të studentëve të bashkërenditura nga Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike si dhe Koordinatorit për mësim praktik të AKSP-së dhe koordinatorëve të mentorëve të Agjencive të Sigurisë Publike.

Studentët e Fakultetit kanë marr pjesë në numër të konsiderueshëm aktivisht në ligjëratat online. Duke marrë parasysh që studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike, në të njëjtën kohë janë punëtor të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike dhe të angazhuar në luftë të cilën po e bëjnë Institucionet e vendit tonë kundër “Covid 19”, krijimi i kësaj platforme ka luajtur rol kyç sepse është krijuar mundësia të përcjellin ligjëratat edhe në kohë më të përshtatshme për ta, meqenëse ligjëratat e mësime të mësimdhënësive incizohen dhe mund të ndjekin në çfarëdo kohe.

Mbrojtja e temës së diplomës –me 7 maj 2020 është realizuar mbrojtja e parë nga distanca e punimit të temës së diplomës në Fakultetin e Sigurisë Publike, nga student i Mentor Gajtani, me titull të temës së diplomës: “Kujdesi shëndetësor dhe sëmundjet më të shpeshta tek të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan”. Studenti Mentor Gajtani është i punësuar si zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe përgjatë katër viteve të studimit, ka ndjekur në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike programin studimor bachelor “Siguria Publike”, drejtimi korrektues.

Organizimi i provimeve online – FSP konformë standardeve të krijuara ka filluar me organizimin e afatit e provimeve të qershorit në mënyrë elektronike.

✓ Hartimi i planit „ Rikthim i mundshëm gradual ne normalitet”

Me 28/04/2020 Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së ka marrë pjesë ne takim përmes platformës elektronike skype me Ministrin e MPAB-së dhe udhëheqësit e Agjencive të kësaj ministrie, ku gjatë takimit është kërkuar nga secila agjenci të hartoj Planin „ Rikthimi i mundshëm gradual në normalitet”

Me 28/04/ 2020 nga MPAB është themeluar grupi punues për hartimin e Planit „ Rikthim i mundshëm gradual ne normalitet” konformë kërkesës së Ministrit të MPBAP-së ku edhe AKSP ka caktuar përfaqësuesin e saj.

Grupi punues i AKSP-së pas takimeve dhe konsultave të shumta ka hartuar dokumentin dhe i njëjti është dorëzuar së bashku me planin e veprimit në MPBAP me datën 04/05/2020.

Bazuar në këtë plan dhe veprimet e parapara janë ndërmarr edhe shumë aktivitete tjera të shumta. Qëllimi i këtij plani është përcaktimi i hapave për rikthimin e mundshëm gradual në normalitet të punës së AKSP-së në përputhje të hapave të planifikuara nga Ministria e Shëndetësisë sipas rekomandimeve të IKSHPK-së për kthim në normalitet .

Plani i AKSP-së për “Rikthim i mundshëm gradual në normalitet” do të bazohet në masat lehtësuese të Ministrit të MSH, të shpallura më datën 30.04.2020.

AKSP-ja ka vepruar në përputhje me këtë plan duke koordinuar stafin në përputhje me kërkesat dhe kushtet e rekomanduara dhe ka ndarë 3 faza të implementimit si vijon:

Faza I - kryerja e punëve nga distanca online

Faza II - kthimi i stafit të reduktuar dhe me rotacion

Faza III - rikthimi në normalitet

Po ashtu është bërë rishikimi i planit vjetor të punës dhe janë caktuar prioritetet mbi bazën e të cilave janë hartuar edhe planet dinamike dhe janë krijuar grupet punuese për realizimin e këtyre aktiviteteve.

✓ Hartimi i dokumentit „ Plani i Qeverisjes për vijimësinë në AKSP“

Me 19 maj 2020 me Vendimin e Ministrit të MPBAP-së është themeluar grupi punues për hartimin e dokumentit „ Plani i Vijueshmërisë për Agjencitë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike gjatë pandemisë COVID 19.

AKSP-ja ka dërguar anëtarin e saj si ndërlidhës mes MPBAP-së dhe AKSP-së. Pas takimeve dhe konsultave të shumta i njëjti dokument „ Plani i Qeverisjes së vijimësisë së AKSP-së“ është hartuar dhe dorëzuar së bashku me planin e veprimit në MPBAP me datën 01/06/2020

AKSP-ja ka caktuar edhe koordinatorin dhe zv. Koordinatorin për mbikëqyrjen e zbatimit të masave të parapara në planet e hartuara si dhe ka zhvilluar takime pothuajse ditore me stafin udhëheqës për zbatimin e rekomandimeve.

✓ Përgatitja e konviktit për karantinë

Me kërkesën e MPBAP-së AKSP-ja ka filluar përgatitjen e objektit të konviktit VIP për qëllime të karantinimit me rastin e rritjes së numrit të infektuarve dhe izoluarve nga pandemia. Me këtë rast është bërë dezinfektimi i të gjitha hapësirave dhe adaptimi i dhomave dhe hapësirave konformë kërkesave të MSH-së dhe IKSHP-së përafërsisht me kapacitet prej 80 persona.

✓ Furnizimi me material higjienik dhe dezinfektues

AKSP-ja me qëllim të mbrojtjes së stafit konformë kërkesave edhe të manualeve dhe rekomandimeve të IKSHP-së dhe MSH-së si dhe planeve të veprimit të hartuara, ka zhvilluar aktivitete të prokurimit për furnizim me pajisje mbrojtëse dhe material dezinfektues.

Janë furnizuar i gjithë stafi me dorëza mbrojtëse si dhe janë vendosur aparate dezinfektuese në të gjitha hyrjet –daljet dhe vendet e frekuentuara.

Po ashtu jemi furnizuar me material dezinfektues të hapësirave dhe objekteve ku janë dezinfektuar të gjitha objektet dhe zyrat e AKSP-së konformë planit të veprimit.

Janë siguruar edhe mjete mbrojtëse për stafin e angazhuar potencialisht me rastin e përgatitjeve të objektit të konviktit për karantinimin.

✓ Fushata vetëdijësuese

AKSP-ja me qëllim të përgatitjes së kushteve për kthim të stafit ka hartuar edhe Udhëzuesin/Protokollin mjekësor nga njësia e mjekësisë. Andaj për krijimin e sensibilizimit të stafit dhe instruktorëve në AKSP në lidhje me masat dhe veprimet me rastin e rikthimit të stafit, AKSP-ja ka organizuar një ligjëratë/prezantim për të gjithë ku të pranishmit janë njoftuar se si të veprohet gjatë orarit të punës me kujdes dhe si duhet zbatuar masat adekuate.

Po ashtu janë hartuar dhe vendosur edhe posterat vetëdijësuese në të gjitha hapësirat e AKSP-së në lidhje me rregullat që duhet ndjekur me qëllim të parandalimit apo minimizimit të shpërndarjes së virusit.

Në të gjitha hapësirat ku mund të ketë kontakte apo pritjet e radhëve është shënuar me vijëzime distanca fizike mes zyrtarëve.

✓ Vizitat e realizuara në AKSP dhe aktivitete tjera

MPBAP Me 09 /04/2020 në AKSP ka qëndruar për vizitë me datën u.d Ministri i MPBAP-së z. Xhelal Sveqlla i cili u njoftua për së afërmi me aktivitetet e AKSP-së gjatë pandemisë me theks të veçante përgatitja e Konviktit si objekt rezervë për nevojat e karantinës dhe realizimi i fushëveprimtaris bazë.

Po ashtu me datë 15/04/2020 ka qëndruar për vizitë zv. Ministri i MPBAP-së z. Bajram Gecaj dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri të cilët u njoftuan për së afërmi me aktivitetet e AKSP-së gjatë pandemisë ku AKSP-ja në rast nevoje do përdorët si karantinë.

Organizimi i takimit të Bordit – Me 23 prill 2020 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Bordi i AKSP-së mbajti takimin e 31 të radhës, ku u diskutua

situatë e krijuar gjatë Pandemisë Covid 19 dhe rolin që po luajnë Institucionet e Sigurisë për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së saj, si dhe u bashkërenduan disa aktivitete të rëndësishme duke shprehur që pas kalimit të pandemisë të vazhdoi puna e Akademisë nga fusha e veprimit të sajë e cila është esenciale për ngritjen e kapaciteteve të Agjencive gjegjësisht ofrimin sa më të mirë të shërbimeve për agjencitë.

OSBE - 26 maj 2020 - Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike Ismail Smakiqi së bashku me menaxhmentin e lartë të AKSP-së, priti për vizitë Drejtorin e Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike në OSBE Edward T. Anderson si dhe zyrtaren e lartë nga kjo organizatë Shpresa Muharremi.

Nënshkrimi i marrëveshjes - Akademia e Kosovës për Siguri Publike me 20 mars 2020 konformë procedurave dhe negociatave të zhvilluara, për shkak të shfaqjes së Pandemisë Covid 19 në mënyrë elektronike ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Akademinë Policore të Malit të Zi

Konferenca online - Drejtori i përgjithshëm i AKSP-së ka zhvilluar konferencë online me partnerin strategjik të AKSP-së Kolegjin Universitar Policor të Finlandës (POLAMK) ku i njëjti është duke zhvilluar Projekt në Akademinë e Sigurisë së Shqipërisë (ASSH). Tema e diskutimit ka qenë shkëmbimi i përvojave dhe modeleve mes AKSP dhe ASSH në kuadër të Marrëdhënieve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar pra rëndësia, zgjerimi, sfidat si dhe vizioni për të ardhmen e AS, Shqipërisë.

Bashkangjitur këtij raporti si dëshmi gjeni:

- *Komunikimet mes menaxhmentit të AKSP-së*
- *Dokumentet/planet e hartuara*
- *Fotografit*